



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani i Elezit

01/ Nr.2959 /2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, (të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 28/2008), Ligjit për Miniera dhe Minerale Nr. 03/L-163, Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa Administrative neni 13, shkresën përcjellëse Nr. 2959 të datës 18.06.2012, raportin e komisionit për vlerësimin e kushteve për eksploatimin e minierave dhe dëmeve të shkaktuara me rastin e eksploatimit të pasurive minerale në tokën bujqësore – pyjore si dhe ndërrim destinimi, me numër Nr.02/2364/2012 të datës 04.05.2012, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.06.2012 mori:

VENDIM PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR HULUMTIM TË GURIT GËLQEROR

I

I jepet pëlqimi firmës „SHARRCEM” SH.P.K për Hulumtimin e gurit gëlqeror në parcelën kadastrale Nr.1116-0 në sipërfaqe prej 41 92 26 ha me kulturë „Pyll” i klasit të pestë (V), në vendin e quajtur „Kodra” që evidentohet në çertifikatën e pronësisë Nr.125 në zonë kadastrale Seçishtë në pronësi të P.SH ekonomia e pyjeve – Hani i Elezit .

II

Pëlqimi i lëshohet për procedurë të më tejshme për hulumtim të gurit, ndërsa për veprime tjera nuk mund të përdoret. Deri në kompletimin e dokumentacionit në të gjitha organet kompetente parashtuesit të kërkesës nuk i lejohet fillimi i punimeve.

III

Firma „SHARRCEM” SH.P.K obligohet që tu përmbahet afateve ligjore për fillimin e punimeve sipas legjislacionit në fuqi në të kundërtën mund të shfuqizohet pëlqimi i dhënë nga Kuvendi i Komunës.

IV

Obligohet „SHARRCEM” SH.P.K që pas përfundimit të hulumtimeve komunës t'i a sjellë rezultatet e hulumtitit.

V

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural.

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

VII

Me këtë pëlqim njoftohen: Kryetari i Komunës, Pala, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:28.06.2012

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlasi

